



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 26 Prot.

Kamëz, më 19.02.2021

V E N D I M

Nr. 23. Datë 19.02.2021

P Ë R

MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË VENDIMIN NR. 168 DATË 23.12.2020 DHE MIRATIMIN E NJË SHITESË TË LISTËN SË SUBJEKTEVE, TË CILËT PËRFITOJNË NGA GRANTET PËR RINDËRTIMIN E SHITËPIVE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMRTIT TË DATËS 26.NËNTOR 2019, VLERËSUAR SIPAS NIVELIT TË DËMTIMEVE NGA DS1-DS3

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më **19.02.2021** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.22 Datë 15.02.2021**, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, aktin nr. 09 datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe aktet nënligjore për zbatim të tij, Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, Vendim Nr.5, datë 06.01.2020 i ndryshuar “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Vendim Nr.8, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kritereve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, Vendim Nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Vendim Nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz “Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit” **Këshilli Bashkiak Kamëz :**

V E N D O S I :

1. Miratimin e një ndryshimi në **Vendimin nr.168 Datë 23.12.2020** të subjekteve përfitues, të cilët plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar nga grantet e rindërtimit për masën e dëmtimeve sipas DS-ve:

- DS1 - Nivel dëmtimi lehtë;
- DS2 - Nivel dëmtimi mesatar;
- DS3 - Nivel dëmtimi serioze;

2. Miratimin për një shtesë në listën e vendimit **Nr.168. Datë 23.12.2020** në listën e subjekteve përfitues, të cilët plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar nga grantet e rindërtimit për masën e dëmtimeve sipas DS-ve

DS1 - Nivel dëmtimi lehtë;
DS2 - Nivel dëmtimi mesatar;
DS3 - Nivel dëmtimi serioze;

3. Miratimin për vlerën në lekë hartuar nga Komisioni Teknik sipas urdhërit të Kryetarit të Bashkisë **Nr. 155 datë 24.02.2020** për përcaktimin e vlerës të masës së grantit të rindërtimit sipas nivelit të dëmtimeve nga tërmeti.

Relacioni u dorëzua pranë Komisionit të Posaçëm me
Nr.3784 prot datë 26.05.2020 dhe si më poshtë vijon:

DS-1 përfiton grantin me vlerë 90,154 (nëntëdhjetë mijë e njeqin e pesëdhjete e kater lekë)
DS-2 përfiton grantin me vlerë 230,060 (dyqind e tridhjetëmijë e gjashtedhjete lekë)
DS-3 përfiton grantin me vlerë 450,062 (katërqind e pesëdhjetëmijë e gjashtedhjete e dy lekë)

4. Lista e subjekteve që shfuqizohennë pikën 1 të këtijvendimi, paraqitet në aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e ketijë vendimi.

5. Lista e subjekteve shtesë përfitues e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, paraqitet në aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Zv/Kryetar i Këshillit

Ali DAUTI

